



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 26.08.2025
Numër Protokolli: 5944/2025

A.nr.1357/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1357/2025, të datës 14.07.2025, të parashtruar nga ankuesja B.S, kundër organit të punësimit: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1357/2025, e datës 14.07.2025, e parashtruar nga ankuesja, B.S.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, B.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 14.07.2025, përmes postës elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me Nr.01/2025 të datës 10.07.2025, për refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00018076, për Grupin e Buxhetit dhe Financave, pozita e punës Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa në Divizionin për Buxhet dhe Financa, të shpallur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e parakohshme, **sepse:**

Nga analizimi i provave të lëndës rezulton se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 27.06.2025, ka shpallur konkursin publik me numër reference RN00018076, për Grupin e Buxhetit dhe Financave, pozita e punës Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme, me kohëzgjatje të emërimit (12) muaj, në Divizionin për Buxhet dhe Financa, i hapur për aplikim nga data 28.06.2025 deri më datën 05.07.2025.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit ka aplikuar edhe ankuesja, e cila sipas Njoftimit Nr.01/2025 të datës 10.07.2025 i është refuzuar aplikacioni më arsyetimin se nuk ka plotësuar kriterin e përvojës së punës, pasi që e njëjta nuk ka bashkangjitur kopjet e dëshmisë së punësimit ku vërtetohet përvoja profesionale.

Ankuesja, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e kundërshtuar njoftimin për refuzimin e aplikacionit, me pretendimin ankimor se gjatë fazës së aplikimit, e njëjta ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e kërkuara përfshirë këtu edhe përvojën e punës së kërkuar sipas konkursit. Kërkon nga Këshilli që ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe të i mundësohet që të vazhdoj me fazat tjera të vlerësimit profesional.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative*, si dhe nenin 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi Në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve*. Andaj, referuar këtij përcaktimi ligjor si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja më datë 14.07.2025, është e parakohshme, ngase, kandidati për pranim në shërbim civil ka të drejtë të parashtroj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesja ka parashtruar ankesë ndaj njoftimit për refuzim të aplikacionit, si veprim procedural në fazën e verifikimit paraprak, kështu që, duke qenë se ankesa është parashtruar ende pa u shpallur njoftimi për rezultatin përfundimtar për procedurën përkatëse të rekrutimit, atëherë, në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ankesa A.nr.1357/2025 është e parakohshme.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë e ankesës si parakohshme, nuk mohon të drejtën e ankueses, që të kundërshtoj vendimin për refuzimin e aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Theksuar si me lart, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1357/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, B.S;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.